

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT



PUNIM DIPLOME

(STUDIMET MASTER)

TEMA: NIVELI I ZHVILLIMIT DHE PERSPEKTIVA E
VOLEJBOLLIT NË MITROVICË

Mentori:
Prof. Dr. Musa Selimi

Kandidati:
Vlora Murati

Prishtinë, 2017

DEKLARATA

Deklaroj se kjo Temë e Diplomës Master është punimi im original. E gjithë literatura dhe burimet tjera që i kam shfrytëzuar gjatë punimit jenë të listuara në referenca dhe plotësisht të cituara.

FALËNDERIME

Ky punim diplome me titull: *Niveli i zhvillimit dhe perspektiva e volejbollit në Mitrovicë*, që është rezultat i një pune të madhe kërkimore, nuk do të ishte realizuar pa kontributin e çmuar të udhëheqësit tim shkencor Prof. Dr. Musa Selimi, ndihmën e kolegëve të Fakultetit të shkencave sportive, si dhe mbështetjen e pakursyer dhe mirëkuptimin e familjes sime.

Në përfundim të tij i falënderoj të gjithë përzemërsisht!

PËRMBAJTJE

DEKLARATA	2
FALËNDERIME	3
PËRMBAJTJE	4
1. HYRJE	5
Gjatë këtij punimi të Diplomës Master do të ndalemi tek një temë shumë e rëndësishme që ka të bëjë me <i>Nivelin e zhvillimit dhe perspektives së volejbollit në Mitrovicë.</i>	5
1.1. Qëllimi	6
1.2. Objektivat.....	6
1.3. Hipoteza kryesore të punimit:.....	6
1.4. Metodrat dhe teknikat.....	7
1.5. Mostrat	7
1.6. Dinamika e Hulumtimit	8
2. FIVB (FEDERATA NDËRKOMBËTARE E VOLEJBOLLIT)	9
3. FEDERATA E VOLEJBOLLIT NË KOSOVË	10
4. VOLEJBOLLI DHE HISTORIKU I TIJ	15
5. ZANAFILLA DHE ZHVILLIMI I VOLEJBOLLIT NË MITROVICË	18
5.1 Loja e Volejbollit pas përfundimit të luftës dhe perspektiva e saj.....	21
5.2 Si qëndron tani loja e Volejbollit në bazë të hulumtimit, me metoda kuantitative dhe kualitative.....	22
9. PARAQITJA E TË DHËNAVE KUALITATIVE	28
5.3 Analiza dhe krahasimi i të dhënave	39
10. PËRFUNDIMI	40
11. LITERATURA	41
CV-it e Intervistuarve	42

1. HYRJE

Gjatë këtij punimi të Diplomës Master do të ndalemi tek një temë shumë e rëndësishme që ka të bëjë me *Nivelin e zhvillimit dhe perspektives së volejbollit në Mitrovicë*.

Mitrovica është qyteti specifik i ndarë në dy komuna të vendosura në veri të Kosovës, e që historikisht njihet si një ndër qytet që ka kontribuar më së shumti në zhvillimin e Kulturës, posaçërisht në atë Sportiv.

Motiv kryesorë për të rinjtë e Mitrovicës, ka qenë sigurimi i hapësirave (vendeve) adekuate për të ushtruar pasionin e tyre që kanë pasur për ndonjë sport, e me theks të veçantë atë të lojës së Volejbollit, pasi që është njohur si një ndër sportet më një atraktivitet shumë të madh për shoqërinë. Pavarësisht sfidave të mëdha që kanë pasur klubet Sportive, ato prapë kanë gjetur forma të ndryshme për të mos shuar aktivitete sportive.

A jo se ç'farë e bënë më të kompletuar paragrafin e sipër është të shohim fillimisht se ç'farë kuptojmë më lojën e Volejbollit dhe historikun e saj?

Loja e Volejbollit karakterizohet më lëvizje të shpeshta dhe dinamike, më aftësi të larta psikomotorike, ndjeshmëri për kohë dhe hapësirë, saktësi dhe baraspeshim të nevojshëm. Ajo se ç'farë e bën më të veçantë lojën e Volejbollit, është puna në grup, ndjenja e kolektivitetit, kreativitetit, vëmendjes, vullnetit etj.

Shikuar historikisht loja e volejbollit u luajt për herë të parë në vitin 1896 në Kolegjin Springfilg, që nga ajo kohë filloj të marrë përmasa të mëdha në vendet e ndryshme botërore, duke u vendosur në programet e tyre si një ndër lojërat më të rëndësishme sportive.

Në Kosovë, Volejbolli filloj si aktivitet sportiv në vitin 1936, ku fillimisht ishte në planprogramet e Shkollave të mesme të Gjimnazit të Prishtinës, Pejës, dhe Prizrenit, e më pastaj u përhap edhe në planprogramet e shkollave të qyteteve tjera. Mitrovica ka filluar qysh në vitet 1910 me aktivitete sportive duke u përfshi këtu edhe Volejbolli, por më mënyrë masivike u përhap në vitin 1946.

Pas kësaj hyrje të shkurtër, ndalemi në strukturën e punimit. Punimi është i konceptuar si një trup dhe përgjithësisht përbën thelbin e zhvillimit dhe perspektivën e volejbollit në Mitrovicë.

Andaj, në këtë punim do të mundohemi, që të japim një kontribut modest lidhur me zhvillimin dhe perspektiven e volejbollit në Mitrovicë. Në këtë formë, synimi i punimit është këtë temë

shumë më interes ta paraqesim në një prizëm shkencor dhe sa më autentik, gjithnjë duke u munduar që në shtjellim e sipër të jemi sa më objektiv.

1.1. Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është që të kuptojmë se ç'farë periudhash historike ka pasur volejboli në komunën e Mitrovicës, cilat kanë qenë perspektivat e këtij sporti, sa i është kushtuar rëndësi zhvillimit të saj si aktivitete sportiv, a janë siguruar hapësira të mjaftueshme ku të rinjtë mundën më perfeksionua këtë aktivitet sportiv.

Ky punim nisët nga parimi që sporti është vlerë për shoqërinë, dhe me këtë premisë do të maten arritshmerit e institucioneve, ekspertëve sportiv, shoqërisë civile, se sa kanë arritur që personat të cilët kanë pasion volejbollin të mund të realizojnë pasionin e tyre, duke i siguruar mjete dhe hapësirë adekuate.

E po ashtu një ndër qëllimet kryesore të këtij punimi është, se sa i kushtojnë rëndësi profesorët e Shkollave të Mesme të larta të Edukatës Fizike lojës së volejbollit, dhe cilat janë kushtet për zhvillimin e kësaj loje brenda ambientit shkollor, gjithashtu të maten edhe njohuritë e nxënësve rreth volejbollit, si dhe shprehja e interesit të tyre për këtë aktivitet sportiv.

1.2. Objektivat

- Roli i Institucioneve rreth krijimit të ambientit të sigurt dhe të përshtatshëm ku të rinjtë mund të zhvillojnë lojën e volejbollit;
- Dhënia e rëndësisë nga Ekspert Sportiv (profesor i Edukatës fizike), Shoqëri civile, rreth zhvillimit të aktiviteteve të volejbollit më të rinj;
- Fuqizimin e të rinjve rreth rëndësisë së lojës së volejbollit.

1.3. Hipoteza kryesore të punimit:

- **Hipoteza kryesore:** Institucionet, Ekspertë Sportiv, Shoqëria Civile ka krijuar hapësira dhe aktivitete rreth lojës së volejbollit.

- **Hipoteza ndihmëse:** Sa më shumë që i kushtohet rëndësi lojës së volejbollit nga ana e Institucioneve, Shoqërisë Civile, aq më shumë do të jetë interesimi i të rinjve të merren më këtë aktivitet sportiv.

1.4. Metodatat dhe teknikat

Në këtë hulumtim do të përdoren metodatat dhe teknikat kuantitative dhe kualitative.

Më anë të metodave kualitative do të bëhen intervista të thella për Institucionet si: (komuna e Mitrovicës, drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Organizata të cilat kanë për objektin inkurajimin e të rinjve rreth aktiviteteve sportive, më profesor të Edukatës Fizike në SHML, e po ashtu edhe me ekspertë sportiv apo ndonjë trajner volejboli).

Me anë të metodave kuantitative me pyetësor do të anketohen të rinjtë të SHML rreth lojës së volejbollit si: Gjimnazi “Frang Bardhi”, Shkolla Ekonomike “Hasan Prishtina”, Shkolla e Mjekësisë “Xheladin Deda”, si dhe Shkolla Teknike “Arkitekt Sinani”.

1.5. Mostrat

Mostrat janë të zgjedhura pra: Institucionet, Organizatat, Ekspert Sportiv-Trajner Volejboli, Profesor të Edukatës Fizike si dhe nxënës të shkollave të mesme të larta.

Nga mostra e përzgjedhur me metoda kualitative intervistat do të zhvillohen përmes pyetësorëve që do të përmbajnë rreth 8 pyetje të hapura, dhe me metoda kuantitative me anketë që do të përmbajnë rreth 10 pyetje të mbyllura, dhe do të jenë rreth 250 pyetësor ku prej tyre do të jenë:


- 1 (një) Intervistë me drejtorinë e Kulturës Rinis dhe Sportit;
- 2 (dy) Intervista më organizata që si objektin të tyre kanë zhvillimin e aktiviteteve sportive;
- 4 (katër) Intervista më profesor të Edukatës fizike;
- 1 (një) Intervistë më ekspertë sportiv-trajner volejboli;
- 200 (dyqind) Anketa për nxënës të shkollave të mesme të larta.

1.6. Dinamika e Huluntimit

Objektivat:	Muaji i I				Muaji i II			
	Java				Java			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV
Përgatitja e Pyetësorëve								
Intervistë me OJQ-të								
Intervistë me profesor të Edukatës Fizike								
Intervistë me drejtor për Kulturë Rini dhe Sport								
Intervistë me ekspert sportiv								
Anketim me nxënës								
Mbledhja e të dhënave								
Analiza e të dhënave								
Raporti								

2. FIVB (FEDERATA NDËRKOMBËTARE E VOLEJBOLLIT)

FIVB është organi qeverisës në botë për volejboll dhe volejboll në plazh, e cila u themelua në Paris, më 20 prill 1947, si një organizatë joqeveritare e përkushtuar në zhvillimin e disiplinave të saj në mbarë botën, përmes përgatitjes së fazave dhe organizimit të garave, kurseve, seminareve ndërkombëtare, si dhe promovimit të veprimtarive të tjera edukative. Kjo arrihet përmes bashkëpunimit të gjerë me 5 konfederatat kontinentale, 220 federatat kombëtare dhe aktorë të tjerë. FIVB ka status ligjor dhe zyret qendrore janë në Lozanë të Zvicrës që nga viti 1984¹.



Zyre qendrore të volejbollit në Lozanë të Zvicrës

¹ Prof. Asoc. Dr. Musa Selimi & Msc. Bahri Gjinoci, *Volejbolli (Metodologjia e të mësuarit)*, Prishtinë, 2014, fq. 7.

3. FEDERATA E VOLEJBOLLIT NË KOSOVË

- Volejboli në Kosovë u shfaq në vitin 1936 në gjimnazet në: Prishtinë, Prizren, Pejë dhe në shoqëritë e “Sokoleve”.
- Më 8 Tetor të vitit 1948 në Kosovë u themelua Këshilli iniciator për lojërat sportive (Volejboll, basketboll dhe hendboll) dhe u formuan disa Seksione për Volejboll – në Prishtinë “Proleteri” dhe “Poleti”, në Pejë “Buduqnost”, në Mitrovicë “Trepça”, në Ferizaj “Borac”, në Prizren “Metohia”, në Gjiilan “C. Zvezda” dhe në Gjakovë “Brastvo”.
- Më 24-28 Tetor 1948 në Prishtinë, u organizua Kampionati i parë në Volejboll më 6 (gjashtë) ekipe.
- Më 20 Mars 1949 u mbajt Kuvendi themelues i këshillit të Volejbollit për Kosovë.
- Më 31 janar 1951 kanë ekzistua 9 seksione dhe një Klub i Volejbollit në Kosovë.
- Kampionati i parë masovik në Kosovë u mbajt në vitin 1956, në të cilin morën pjesë 22 ekipe.
- Në çdo dy vite në kuadër të lojërave të Shkollave të mesme të Kosovës organizoheshin edhe garat në Volejboll.
- Gjatë Historikut, Volejboli në Kosovë pati batica dhe zbatice e veta.
- Në vitin 1958 në Prishtinë ka qenë organizua turneu i parë kualifikues për ligen unike të Serbisë, ku edhe ekipi i Prishtinës u kualifikua për rangun më të lartë në atë kohë në Serbi.
- Prej vitit 1960 në Kosovë ekzistojnë 2 (dy) liga të volejbollit për meshkuj.
- Ekipi i volejbollit Prishtina prej vitit 1958 bënë gara në ligen Unike të Serbisë dhe më pastaj është anëtare e ligës së dytë Federative.
- Në Kampionatin e viteve 196/1967, 4 (katër) ekipe nga Kosova marrin pjesë në ligen e dytë Federative (jugu) të ish Jugosllavisë.
- Gjerë më vitin 1990 ekipi KV. Prishtina-Elektroekonomia – 4 (katër) herë morri pjesë në kualifikime për të hyrë në ligen e parë të Jugosllavisë, dhe gjithnjë për një njansë të vogël nuk ia arrinte qëllimit².

² <http://www.fvk-ks.org/?page=1,122>

- Garat në konkurrencën e femrave, për herë të parë në formë lige janë organizuar në vitin 1975.
- Ekipi i volejbollit “Universiteti” nga Prishtina për femra ishte ekipi i parë që ishte anëtare e ligës së dytë Federative të ish Jugosllavisë.

Kryetar i pare i FVK-ës të sapo themeluar ishte delegati nga Gjakova, z. Honi Hoxha, kurse anëtar tjerë ishin z. Ismajl Hyseni, Shefki Mustafa, Rexhep Zaskoku (tani të ndjerë) Xhavit Mustafa, Fejzullah Ademi, Xhevdet Buçani, Hajrush Fazliu etj.

Organizimi i garave filloi hap pas hapi që të pësojë ndryshime, kështu që prej garave në formë të grumbulluara një ditore, kaluan në gara dyditore me pjesëmarrje të ekipeve në numër më të madh, në çdo grumbullim të ardhshëm paraqiteshin edhe ekipe të reja, kështu që prej turneut të parë me 1991 kur u grumbulluan 10 ekipe, në grumbullimet e ardhshme numri rritej në dhjetë. Në këtë periudhë kemi pasur një kontakt më ekipet e Shqipërisë ku përzgjedhja e Kosovës merrte pjesë në turneun e organizuar nga ana e klubit Volejbollistik “STUDENTI” i Tiranës, ku pjesëmarrës ishte edhe ekipi nga Maqedonia “Vardar” nga Shkupi dhe “Dinamo” Tiranë. (23-25-shkurt 1993).

Gjatë mbajtjes së turneut në fjalë udhëheqësia e ekipit të Kosovës u prit nga Komiteti Olimpik Shqiptar në krye me Z. Arben Jorganin, kryetar dhe zonj. Arijeta Gaçe, nënkryetare.

Duke vepruar në kushte shumë të vështira, pa mjete materiale, pa siguri, kurse dëshira e madhe, për të bërë një organizim më të mirë, pasi që e krejt barra e këtyre aktiviteteve ka ra në tre –katër veta në vitin 1994 u mblodhën përfaqësuesit e ekipeve, bën koptimin e anëtarëve të rinjë të kryesisë dhe rizgjedhën kryesuesit e rinjë; kryetar Fejzullah Ademi, nënkryetar Hafiz Gashi, sekretar Ismajl Hyseni, Prof. Enver Gjinolli, Xhavit Mustafa, Xhevdet Buçani, Honi Hoxha, Makfire Brestovci, Refki Ejupi, Naser Krasniqi, Rexhep Zaskoku.

Më 1993 për herë të parë u organizua edhe turneu i ekipeve femërore në Gjilan, në turneun në fjalë merrnin pjesë ekipi i KV “Drita” nga Gjilani, Universiteti Prishtinë, Arbëria Kamenicë, Kastrioti Ferizaj, Komogllava Komogllavë dhe ekipi Iliria Leshkobare. Pas turneut në fjalë u organizua edhe liga në konkurrencën e femrave³.

Më vone garat u zhvilluan në forma të ndryshme. Kështu garat i organizuam në dy grupe, ku ekipet u ndanë sipas përkatësisë territoriale, në mënyrë që rreziku nga policia serbo-sllave të jetë sa më i vogël, por ende në formë të grumbulluar, nga 7-8 ekipe nëpër grupe. Garat shtesë për

³ <http://www.fvk-ks.org/?page=1,122>

Kampioni i Kosovës u organizuan në formë të Pley-Ofi-t ku morën pjesë nga dy ekipe nga grupet e cekura më lartë. Por prapë duke pasur në agjendë organizimin më të mire dhe njëherit sigurinë e pjesëmarrësve, garat filluan t'i organizojmë në një ligë e cila përbëhej prej ekipeve më të mira prej dy grupeve (nga 5 ekipet e para) kështu që liga e parë numëronte nga 10 ekipe në të dy konkurrencat (femra e meshkuj) kurse liga e dytë përbëhej në fillim prej 8 ekipeve e më vonë (1997) i kishte 12 ekipe në konkurrencën e meshkujve dhe 6 ekipe në konkurrencën e femrave, gjithnjë duke e pasur parasysh organizimin në formë të grumbullimit (një xhiro në një vend).

Në kuadër të ligave të sipër përmendura kanë marrë pjesë më tepër se 60 ekipe aktiviteti i të cilave ka zgjatur prej 1-2 kampionate por për shkak të kushteve janë detyruar të ndërpresin aktivitetin e tyre. Në këtë periudhë ekipet të cilat kanë qenë pjesëmarrës standard në të gjitha kampionatet prej pavarësimit të sportit (1991) e deri më sot janë: në konkurrencën e femrave, Drita Gjilan, Mabetexi, Prishtinë (ish Keku, Universiteti) Kastrioti Ferizaj, Gjinoci Gjinoc kurse më vonë janë Ulpiana Lypian, Skenderaj Skenderaj, ekipet anëtare të SUPERLIGËS aktuale, Vllaznia e Pozharanit, Deçani i Deçanit, Dukagjini i Klinës, Kalaja e Prizrenit, Aurora Kastriot, Malisheva nga Malisheva, Gryka nga Lapushniku, anëtare të ligës së parë aktuale të Kosovës, kurse, deri vonë anëtare të ligës së parë të Kosovës Studenti Dobërçan, Arbëria Arbëri, Egnatia Bale, e më herët Iliria Leshkobare, Komogllava Komogllav, Sllatina Sllatinë, Flaka nga Presheva, Marigona, Rilindja nga Rogana edhe disa ekipe të cilat kanë fillua dhe pas një kohe të shkurtër e kanë ndërprerë aktivitetin.

Në konkurrencën e meshkujve ekipet që kanë qenë pjesëmarrëse standarde në të gjitha kampionatet janë: Suhareka nga Suareka, Mabetexi (ish Keku, Universiteti), Shpella e Mermerit Gadime, Drita nga Gjilani, Dukagjini nga Klina, Arbëria nga Arbëria, Bresalci nga Bresalci, Flaka nga Presheva, Vllaznia Pozharan, (tan e kanë ndërprerë aktivitetin ???), më vonë janë inkuadruar edhe Vllaznimi Gjakovë, Ejona, Pejë, Miqësia, Ardi Suarekë, Rahoveci, Mercomi Burim Burim, Trepça, Gjinnazisti Skenderaj, Studenti Dobërçan, Dardana, Dardan (Nobërd), Kastrioti Ferizaj, Ferizaj, Ulpiana Lypian, Mirashi Mirash, FKF Prishtinë edhe shumë ekipe tjera të cilat kanë garuar vetëm nga një sezon dhe pastaj i kanë ndërprerë aktivitetet për shkak të kushteve të vështira materiale⁴.

Kampion të Kosovës gjatë kësaj periudhe (1991-1999) në konkurrencën e femrave kanë qenë: Drita e Gjilanit, Kastrioti Ferizaj, dhe Gjinoci Gjinoc. Në konkurrencën e meshkujve kampion të

⁴ <http://www.fvk-ks.org/?page=1,122>

Kosovës kanë qenë: Dukagjini – Klinë, Suareka- Suarekë, Flaka Preshevë, Bresalci- Bresalc, Drita- Gjilan.

Të gjitha garat në fillim janë organizuar nëpër qendra të cilat kanë qenë më larg syve të policisë serbosllave, si në Gadime, në f. Bellanicë të komunës së Suarekës, në Bresalc e më vonë në qendrat tjera të Kosovës në Gjilan, Prishtinë, Gjakovë, sidomos pjesën dërmuese të garave i kemi zhvilluar në palestrat e shk. f “Selami Hallaqi” në Gjilan, “Zenel Hajdini” në Bresalc, “Asim Vokshi”, “Zenel Hajdini”, “Iliria” në Prishtinë. FVK është shumë mirënjohëse drejtorive të këtyre shkollave për kontributin e dhënë në organizimin garave të Volejbollit.

Krahas garave kampionate janë organizuar dhe zhvilluar edhe garat për Kupën e Kosovës, ku pjesëmarrës kanë qenë të gjitha ekipet e lartë përmendura .

Fitues të Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave kanë qenë “Drita”- Gjilan, “Kastrioti”- Ferizaj, etj.

Më 1993 për herë të parë u organizua edhe turneu i ekipeve femërore në Gjilan, në turneun në fjalë marrin pjesë ekipi i KV “Drita” nga Gjilani, Universiteti Prishtinë, Arbëria Kamenicë, Kastrioti Ferizaj, Komogllava Komogllavë dhe ekipi Iliria Leshkobare. Pas turneut në fjalë u organizua edhe liga në konkurrencën e femrave.

Në këtë periudhë garat fillojnë të zhvillohen në mënyrë më të rregullt, gjithnjë duke pasur parasysh mundësit dhe kohën e atëhershme në përgjithësi. Kështu garat u organizuan në dy grupe, ku ekipet u ndanë sipas përkatësisë territoriale, në mënyrë që rreziku nga policia serbosllave të jetë sa më i vogël, por ende në formë të grumbulluar, nga 7-8 ekipe neper grupe.

Garat shtesë për Kampion të Kosovës u organizuan në formë të Pley-Ofi-t ku kanë marrë pjesë nga dy ekipe nga grupet e cekura më lartë. Por prapë duke pasur në agjendë organizimin më të mirë dhe njëherit sigurinë e pjesëmarrësve, garat filluan t’i organizojnë në një ligë e cila përbëhej prej ekipeve më të mira prej dy grupeve (nga 5 ekipet e para) kështu që liga e pare numëronte nga 10 ekipe në të dy konkurrencat (femra e meshkuj) kurse liga a dytë përbëhej në fillim prej 8 ekipeve e më vonë (1997) i kishte 12 ekipe në konkurrencën e meshkujve dhe 6 ekipe në konkurrencën e femrave, gjithnjë duke e pasur parasysh organizimin në formë të grumbullimit (një xhiro në një vende)⁵.

Në kuadër të ligave të sipër përmendura kanë qenë pjesë më tepër se 60 ekipe aktiviteti i të cilave ka zgjatur prej 1-2 kampionate por për shkak të kushteve janë detyruar të ndërpresin aktivitetin e

⁵ <http://www.fvk-ks.org/?page=1,122>

tyre. Në këtë periudhë ekipe të cilat kanë qenë pjesëmarrës standard në të gjitha kampionatet prej pavarësimit të sportit (1991) e deri më sot janë: në konkurrencë e femrave, Drita Gjilan, Mabetexi, Prishtinë (ish Keku, Universiteti) Kastrioti Ferizaj, Gjinoci Gjinoc kurse më vonë janë Ulpiana Lypian, Skenderaj Skenderaj, ekipe anëtare të SUPERLIGËS aktuale, Vllaznia e Pozharanit, Deçani i Deçanit, Dukagjini i Klinës, Kalaja e Prizrenit, Aurora Kastriot, Malisheva nga Malisheva, Gryka nga Lapushniku, anëtare të ligës së parë aktuale të Kosovës, kurse, deri vonë anëtare të ligës së parë të Kosovës Studenti Dobërçan, Arbëria Arbëri, Egnatia Bale, e më herët Iliria Leshkobare, Komogllava Komogllav, Sllatina Sllatinë, Flaka nga Presheva, Marigona, Rilindja nga Rogana edhe disa ekipe të cilat kanë fillua dhe pas një kohe të shkurtër e kanë ndërprerë aktivitetin.

Në konkurrencën e meshkujve ekipet që kanë qenë pjesëmarrëse standarde në të gjitha kampionatet janë: Suhareka nga Suareka, Mabetexi (ish Keku, Universiteti), Shpella e Mermerit Gadime, Drita nga Gjilani, Dukagjini nga Klina, Arbëria nga Arbëria, Bresalci nga Bresalci, Flaka nga Presheva, Vllaznia Pozharan, (të gjithë e kanë ndërprerë aktivitetin ???), më vonë janë inkuadruar edhe Vllaznimi Gjakovë, Ejona, Pejë, Miqësia, Ardi Suarekë, Rahoveci, Mercomi Burim Burim, Trepça, Gjinnazisti Skenderaj, Studenti Dobërçan, Dardana, Dardan (Nobërd), Kastrioti Ferizaj, Ferizaj, Ulpiana Lypian, Mirashi Mirash, FKF Prishtinë edhe shumë ekipe tjera të cilat kanë garuar vetëm nga një sezon dhe pastaj i kanë ndërprerë aktivitetet për shkak të kushteve të vështira materiale.

Kampion të Kosovës gjatë kësaj periudhe (1991-1999) në konkurrencën e femrave kanë qenë: Drita e Gjilanit , Kastrioti Ferizaj, dhe Gjinoci Gjinoc. Në konkurrencën e meshkujve kampion të Kosovës kanë qenë: Dukagjini–Klinë, Suareka- Suarekë, Flaka Preshevë, Bresalci- Bresalc, Drita- Gjilan.

4. VOLEJBOLLI DHE HISTORIKU I TIJ

Volejboli është një sport në të cilën luajnë dy ekipe me nga gjashtë lojtarë të ndara nga një rrjetë, ku karakterizohet me lëvizje të shpejta dhe dinamike. Qëllimi është hedhja e topit në anën e kundërt të rrjetës gjegjësisht në fushën e kundërshtarit në atë mënyrë që kundërshtari të mos arrij ta mbaj topin në ajër dhe mos ta kthejë në fushën e kundërshtarit para se të bjerë në tokë. Loja luhet me tri ose pesë sete, do të thotë më dy sete të fituara. Setet fitohen kur arrihen 25 pikë, por diferenca duhet të jetë me dy pikë. Seti i fundit gjegjësisht i pesti luhet deri në pesëmbëdhjetë pikë. Ai njihet si sport kërkimorë, ku kjo nënkupton së nuk ka posedim të topit nga lojtarët më përjashtim kur bëhet shërbimi, andaj duhet kushtuar rëndësi trajnimit e lojtarëve, organizimin e tyre, rrjedhojën e lojës.

Karakteristikat që e bëjnë më të veçantë lojën e volejbollit janë: ofron pak informata kthyesë pozitive, nuk ka kufizim në kohë, rolet tradicionale për sulm dhe mbrojtje janë të kundërta. Villiam G. Morgan instruktor dhe drejtues i sportit në YMCA (Young Men's Christian Association) në Holyoke në vitin 1895 shpiku lojën e volejbollit. Ai duke u bazuar në karakteristikat e disa lojërave sportive si: basketbollit, tenisit bejsbollit dhe hendbollit vendos të bëjë një lojë të re me emrin mintonete. Villiam Morgan vendosi që t'i bashkojë disa nga elementet teknike të lojërave të lartpërmendura dhe kështu ai shpik një lojë të re për biznesmenët që i ushtronte, lojë e cila do të kishte më pak kontakt fizik në mes të lojtarëve të dy skuadrave që loznin këtë lojë të re sportive. Atij basketbolli i dukej një lojë sportive shumë e ashpër. Morgan huazon rrjetën nga tenisi dhe atë e ngrit në një lartësi pak mbi kokën e një njeriu mesatar⁶.

Kur Morgani demonstronte këtë lojë të re dikush nga të pranishmit vërejti se topi kalohet nga njëra anë e rrjetës në atë tjetrën pa rënë në tokë dhe pa u hamend tha se kjo lojë duhet që patjetër të quhet volejbol. Ky emër më së shumti i ngjanë përshkrimit të lojës së posa shpikur dhe për këtë shkak ajo më tutje e ruan emërtimin VOLEJBOLL⁷.

Më 7 korrik të vitit 1896 u luajt loja e pare e volejbollit në Kolegjin Springfield.

Në vijim 1900 dizajnohet topi i parë special për volejbol. Në të njëjtën kohë YMCA promovon volejbollin në Kanada, Orient (shtetet e Lindjes; hemisfera lindore) dhe hemisferën Jugore.

Në vitin 1905 YMCA përhap volejbollin në Kubë".

⁶ Myftari Zyberi, *Mbrojtja në volejbol*, Tetovë, 1997, fq. 4

⁷ Po aty, fq. 5.

Në vitin 1907 në konventën e shoqatave sportive Amerikane volejboli prezantohet si një ndër sportet më të popullarizuara në Amerikë.

Në vitin 1909 YMCA prezanton volejbollin në Porto Riko, kurse më 1912 në Uruguai dhe më 1912 në Brazil.

Në vitin 1913 volejboli futet në programin e Lojërave Aziatike.

Në vitin 1916 në Filipine për herë të parë fillon të aplikohet një stil ofenziv i kësaj loje. Pranimi i shërbimit bëhet me një trajektore të lartë me qëllim që ndonjëri nga sulmuesit ta gjuan dhe ta dërgoi atë nga ana e tjetër e rrjetës. Këtë mënyrë e gjuajtjes Filipinasit e quajtën "Bomberino"-bombë ose gjuajtje vrasëse.

Në vitin 1917 ndryshon numri i pikëve më të cilat fitohet një set edhe atë prej 21 në 15.

Në vitin 1917 volejboli fillon të përhapet në kontinentin e Afrikës dhe Evropës. Në Evropë kjo lojë sportive së pari përhapet në France. Gjatë Luftërave Ballkanike ky sport përhapet edhe në vendet e Ballkanit nga ushtarët francez, së pari në Strumicë të Maqedonisë dhe më pastaj në shtetet tjera të Evropës⁸.

Në vitin 1919 forcat Amerikane u distribuojnë 16.000 topa volejboli trupave të tyre dhe atyre aleate. Kjo gjë ndikoi që volejboli të stimulohet dhe të përhapet edhe më gjerë dhe më shpejt.

Në vitin 1920 vendoset që në një anë të fushës të ketë vetëm tre kontakte më topin.

Në vitin 1922 në Brooklyn të shtetit Neë York mbahet Kampionati i Parë Kombëtar Amerikan ku morrin pjesë 27 skuadra nga 11 shtete të SHBA-së.

Në vitin 1928 themelohet Lidhja Volejbolistikë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e cila sot mban emrin USA Vollejball.

Në të njëjtin vit d.m.th. më 1928 bëhet përpjekja e parë që të themelohet Federata botërore e Volejbollit (FIVB), por pa sukses.

Në vitin 1930 organizohet loja e pare në volejboll të plazhit (Beach volleyball) me nga dy lojtarë (meshkuj).

Në vitin 1934 bëhet miratimi i gjyqtarëve nacional Amerikan të volejbollit.

Në vitin 1934 në Stokholm të Suedisë bëhet përpjekja e dytë për të themeluar Federatën Botërore të Volejbollit, por edhe kësaj here pa sukses, pasi nuk mundën të unifikohen rregullat e volejbollit në tërë botën.

⁸ Myftari Zyberi, *Mbrojtja në volejboll*, Tetovë, 1997, fq. 6.

Në vitin 1940 për herë të parë promovohet pranimi i topit nga shërbimi me llëra (parakrah). Gjer në këtë kohë topi pranohej me gishtërinjtë.

Në vitin 1946 në Pragë të Çekisë konstituohet komisioni i FTVB-së dhe më 1947 në Paris të Francës u organizua Kongresi i Parë i FTVB-së me pjesëmarrjen e 14 shteteve të Botës.

Në vitin 1949 mbahet Kampionati i Parë Botërorë në Volejboll në Pragë të Çekisë⁹.

Në vitin 1957 Komiteti Botërorë Olimpik vendosë që volejbollit të futet në programin e Lojërave Olimpikë si sport ekipor në Lojërat olimpikë që do të mbahen në vitin 1964 në Tokio të Japonisë.

Në vitin 1959 Federata Internacionale Sportive Universitare FISU në Turin të Italisë organizon lojërat e para Sportive Universitare dhe këtu volejbollit ishte njëri nga tetë sportet garuese.

Në vitin 1960 futen elementë teknik të rinj në lojën e volejbollit si: ngecja (sulmi me dredhi), pranimi i topit me llëra (bump), bllokimi i sulmit mbi rrjetë dhe plonzhoni.

Në vitin 1964 volejbollit bëhet pjesë në Lojërat Olimpikë të Tokios në Japoni.

Në vitin 1974 për herë të parë volejbollit transmetohet nëpërmjet televizionit. Nga Meksika transmetohet gjallë një ndeshje për shikuesit Japonez.

Në vitin 1983 themelohet Asociacioni i Profesionalistëve Amerikan të Volejbollit për meshkuj, kurse në vitin 1986 ai i femrave.

Viti 1987 korrespondon me organizimin e Kampionatit të Parë Botërorë në Volejboll të Plazhit (Beach Volleyball). *(Foto ilustrative e lojës së volejbollit në plazh)*



Në vitin 1990 themelohet Liga Botërore e Volejbollit.

Në vitin 1995 është viti jubilar i 100 vjetorit të ekzistimit të volejbollit dhe tani ka më tepër se 800.000.000 lojtarë që lozin së paku një herë në javë volejboll.

Në vitin 1996 volejbollit i plazhit (dy lojtarë) bëhet sport olimpik ekipor¹⁰.

⁹ Musa Selimi "Volejbollit". Digiprint, Prishtinë 2004, fq. 15.

¹⁰ Po aty, fq. 19.

5. ZANAFILLA DHE ZHVILLIMI I VOLEJBOLLIT NË MITROVICË

Jeta sportive në Mitrovicë e rrethinë, ka filluar më intensivisht të zhvillohet nga fillimi i dekadës së katërt të këtij shekulli, përkatësisht kur nisi prodhimi në xeheroren e Trepçës dhe kur në numër përherë më të madh vijnë punëtorët nga vendet e tjera, por kjo nuk do të thotë se të rinjtë nuk janë marrë edhe më përpara me sport e cila kryesisht bëhej në mënyrë të paorganizuar dhe spontane, si ato në tubimet fshatare, sidomos gjatë kremtimeve, ahengjeve, festave të tjera, ku mbaheshin gara vrapimi, hedhje guri, dhe mundje.

“Mirëpo aktiviteti i parë i organizuar nis në vitin 1910 kur në Mitrovicë themelohet shoqata e Sokolëve (të skifterëve)”¹¹, ku kjo shoqatë ishte themeluar si organizatë gjimnastikore, detyra e parë ishte edukimi trupor i të rinjve, edhe pse kjo shoqatë ka pasur edhe karakter politik, por qëllimi ishte që të krijoheshin kushte për zhvillimin e lojërave sportive, bazën e shihnin fillimisht në gjimnastikë, dhe futboll e më pastaj me aktivizim e lojërave të tjera: si klubi i alpinistëve, hendbollit, atletikes, biciklistave, e ndër to edhe volejbollit, por në kushte të vështira të improvezuara më tepër në forma të ndryshme, dhe mu për këtë nuk flitet për masivizim, ku shkaqet kryesore kanë qenë të karakterit material, sepse të gjitha klubet sportive janë mbajtur prej antarsisë, pasi që as nga buxheti komunal nuk parashikoheshin mjete për zhvillimin e sportit. Mungesa e kushteve vazhdoi me vite të tëra, ku kishte as një sallë për zhvillimin e lojrave sportive, dhe kishte vetëm një profesor të Edukatës fizike në tërë territorin, prap entuzazmi dhe inciativa e të rinjëve për tu marrë me sport nuk mungonte, ku në vitin 1947 e formuan shoqatën “Trepça”¹², të cilët arritën t’i mblidhnin njëqind të rinjë, ku përveç sporteve tjera ata merreshin edhe me lojën e Volejbollit, kjo shoqatë arriti ta ketë poligonin e vetë, ku ishte i rregulluar nga vetiniciativa e lojtarëve, ky poligon gjendej në oborrin e një shtëpie private ku zhvilloheshin vetëm lojërat e basketbollit dhe volejbollit.

¹¹Ali Hadri dhe Zhivko Avramoski, “*Mitrovica dhe rrethina*”, Mitrovicë 1979, fq. 188.

¹²Tahir Abdylë, “*Mitrovica e Titos*”, Prishtinë 1985, fq. 164.



Fotografi e cila tregon mënyrën e organizim te lojës se volejbollit ne oborre e shtëpive private gjatë viteve 1947

Pas formimit të shoqatës “Trepça” filluan të organizoheshin turnire që mbaheshin në Zveçan, Stantërg dhe qytet tjera të Kosovës, ku në vitin 1948 u organizuan lojrat sportive të Xehetarëve të Serbisë. Në këto gara morën pjesë përfaqësuesit e Trepçës, të cilët arritën rezultatet të dukshme: ekipi i femrave në Volejboll, zuri vendin e dytë, kurse ai i meshkujve vendin e pestë. Këto gara ishin nxitje e fuqishme për zhvillimin e aktiviteteve sportive edhe në periudhat e ardhëshme, ku filluan të formohen klube, e që volejboli ende vazhdonte të mbetej nën shoqatën gjimnastikore “Trepça”, për një kohë të gjatë ato funksiononin me një emërtim si “Sporte të vogla: basketboli, volejboli, dhe hendboli”, pasi që objektet e tyre kanë qenë të përbashkëta, mirëpo ato fillojnë të përparojnë me masivitetit dhe cilsi, ku angazhohen shumë aktivistë që i ndihmuan në zhvillimin dhe investimin për mirëmbajtjen e objekteve përkatëse.

Ndër vite u formuan edhe shumë shoqata të tjera, të cilat i ndihmonin aktiviteteve sportive në avancim dhe përparim, ku kryesisht përfshiheshin shumë sporte, e ndër to ishte edhe shoqata “Partizani”¹³, e cila e ndihmoi volejbollin të tubonte një numër të madhë të rinjesh dhe të formonte klubin e vet Volejbollistik në vitin 1960, dhe e mori emrin “Trepça”. Suksesi më të mëdha të këtyre sportistëve ishin se ata u bënë tre here kampionate të Kosovës, më pastaj u bënë antare të Ligës së Dytë Federative të volejbollit përgjat vitit 1975/76.

Në vitin 1977 klubi garon në kampionatin e Ligës Krahinore të Volejbollit.

¹³ Po aty, fq 168

Volejboli i femrave aty ka mesi i viteve gjashtëdhjetë pushoi së egzistuari, por para pak kohe u ripërtri, madje në Zubin Potok, u formua klubi volejbollistik “Mokra Gora”, ku antarët e këtij klubi me mjaft sukses kanë marrë pjesë në ligën e Kosovës.

Për zhvillimin e lojës së Volejbollit kanë kontribuar punojësit duke dhënë mjete të konsiderueshme në të holla për këtë qëllim, duke kontribut për popullarizimin e aktiviteteve sportive si në gara ashtu edhe në rekreacion.

Por, vlenë të theksohet se traditës sportive në masovizim i kanë ndihmuar puntorët me fillimin e punës në xehrorën “Trepça”.

Kjo ishte periudha që ndryshe quhej “Mitrovica e Titos”¹⁴, gjer në vitin 1980.

Pas këtij viti filluan destabilitet politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, tensione të ndryshme, protesta, masakra, që ndikuan në një formë ose tjetër të shuhen shoqata e klubet sportive, që ndër to ishte edhe klubi i Volejbollit, mirë po shkollat fillore deri në vitin 1996 vazhdonin ndërkohë të organizonin turnire në lojën e Volejbollit.

¹⁴ Po aty, fq 169

5.1 Loja e Volejbollit pas përfundimit të luftës dhe perspektiva e saj

Si çdo qytet i Kosovës, edhe Mitrovica ishte ndër qytetet që ka pësuar më së shumti nga dëmet e luftës, qoftë ato materiale, sociale apo edhe kulturore.

Gjatë luftës janë bërë djegëja, shkatërrimi jo vetëm i shtëpive, por edhe i palestarve apo edhe sallave sportive. Ikja apo dëbimi i shqiptarëve jashtë vendit për shkaqe sigurie e ndër ta edhe shumë lojtarë, ka ndikuar që edhe në periudhat e pasluftës shume aktivitete sportive të jenë të shuara, e ndër to edhe Volejboli.

